

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT:

SHËRBIMET KOMUNALE TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË KOMUNËN E SUHAREKËS

PËRSHKRIMI I SEKTORIT

Sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë menaxhohet nga organet e qeverisjes qendrore dhe lokale. Qeveritë lokale janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, të cilin shërbim deri tani e kanë kryer kryesisht përmes kompanieve regjionale të mbeturinave në pronësi publike. Shërbimet e deponimit të mbeturinave sigurohen kryesisht nga kompania e menaxhimit të deponive në pronësi publike (KLMC). Sektori i menaxhimit të mbeturinave është i rregulluar aktualisht nga Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave (ZRRUM) dhe Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH).

GJENDJA E SEKTORIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË KOMUNËN E SUHAREKËS

Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në komunën e Suharekës tradicionalisht janë ofruar vetëm nga ndërmarrja publike Ekoregjioni SHA. Komuna e Suharekës ka në pronësi 13.1% të aksioneve në kompani, ndërsa aksionar dominant është komuna e Prizrenit me 65.5%. Aktualisht, vetëm 13 nga 41 vendbanime (31,7%) janë të mbuluara nga Ekoregjioni SHA. Afërsisht 18-25 tonë mbeturina grumbullohen çdo ditë në komunë.

Ekoregjioni SHA ka një aranzhim kontraktual me Kompaninë Kosovare të Menaxhimit të Deponive (KLMC), që menaxhon, përmes një aranzhimi kontraktual me operatorin privat, deponinë e Prizrenit, që përdoret për shkarkim të mbeturinave të mbledhura në komunën e Suharekës.

Megjithatë, përveç mbulueshmërisë relativisht të vogël me shërbime, përgjithësisht ekziston një nivel i ulët i kënaqësisë në komunë sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave nga Ekoregjioni SHA.

Në dritën e kësaj suate, dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, komuna ka kontraktuar një kompani private ("IS-Company") për të kryer shërbimet e grumbullimit të mbeturinave përveç shërbimeve që ofrohen nga Ekoregjioni SHA. Angazhimi i kësaj kompanie private synon të shërbejë gjithashtu si një pilot-projekt për të testuar nëse angazhimi i sektorit privat do të përmirësonte performansën e grumbullimit të mbeturinave. IS-Company operon në bazë të një kontrate njëvjeçare të lidhur me komunën. Kompania private është përgjegjëse për të mbuluar afërsisht 50% të territorit të komunës. Pasi që zonat e shërbimit janë të



ndara dhe klientët nuk kanë mundësi të zgjedhin ofruesin e shërbimeve, nuk ka konkurrencë ndërmjet Ekoregjioni SHA dhe kompanisë private. Shërbimet e ofruara nga kompania private përgjithësisht konsiderohen më efektive dhe më efikase dhe klientët janë më të kënaqur. Kjo reflektohet gjithashtu në nivelin më të lartë të pagesave të inkasuara ndonëse tarifat e vendosura nga Ekoregjioni SHA dhe nga kompania private janë të njëjta, dmth 4.50 euro (përfshirë TVSH-në prej 16%) për ekonomi familjare në muaj.

ARSYESHMËRIA E PROJEKTIT

Studimi i fizibilitetit i kryer për projektin tregon që është e mundur arritja e objektivave të përcaktuara. Projekti është financiarisht i zbatueshëm, pa nevojë për subvencione të jashtme, dhe është atraktiv për investuesit potencial nga sektori privat. Shpenzimet e komunës për organizim të tenderit dhe për mbikëqyrjen e operacioneve në të ardhmen mund të mbulohen nga tarifa e koncesionit.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

<ul style="list-style-type: none">• Objektivi i përgjithëm:	Objektiv i përgjithshëm i projektit është përfshirja e sektorit privat me anë të një aranzhimi kontraktual në grumbullimin dhe veçimin e mbeturinave në komunë, për të përmirësuar gjendjen aktuale të menaxhimit të mbeturinave dhe veçmas për të rritur mbulueshmërinë e shërbimeve dhe cilësinë e shërbimeve.
<ul style="list-style-type: none">• Autoriteti kontraktues:	Komuna e Suharekës
<ul style="list-style-type: none">• Shërbimet e kërkuara:	Operatori privat do të ofrojë këto shërbime primare të menaxhimit të mbeturinave: <ul style="list-style-type: none">• Grumbullimi i mbeturinave komunale;• Dizajni, ndërtimit, financimi, operimi dhe mirëmbajtja e objektit për veçim të mbeturinave;• Transporti i mbeturinave të grumbulluara në një deponi të përshtatshme dhe të autorizuar me ligj. Përveç kësaj, operatori privat do të ofrojë këto shërbime plotësuese të menaxhimit të mbeturinave: <ul style="list-style-type: none">• Heqja dhe spastrimi i deponive të paligjshme të mbeturinave;• Pastrimi dhe heqja e mbeturinave nga shtrati i lumenjve dhe buzë rrugëve;• Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve;• Pastrimi i tregjeve, varrezave, parqeve publike dhe hapësirave publike.
<ul style="list-style-type: none">• Struktura e Transaksionit:	Koncesioni i shërbimeve
<ul style="list-style-type: none">• Kohzgjatja e pritur e kontratës:	10 vite

INTERESI I PRITUR I INVESTITORËVE:

Komuna e Suharekës ka treguar një interesim të konsiderueshëm sa i përket përfshirjes së sektorit privat në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Administrata ka nisur gjithashtu një pilot projekt për të testuar bashkëpunimin me një kompani private.

Pas aprovimit të projektit nga ana e Komitetit PPP, si dhe nga Kuvendi Komunal i Suharekës, Komuna e Suharekës ka mbajtur një konferencë për investitorët potencial, e cila do të shërbej për testim të interesit të investitorëve dhe ndryshimet eventuale të KpK.

STATUSI I PROJEKTIT:

Projekti është aprovuar nga ana e Komitetit për Partneritet Publiko Privat me datën 03 shkurt, 2012. Së shpejti pritet shpallja e Kërkresës për Kualifikim nga ana e Komunës së Suharekës.

MENAXHIMI I PROJEKTIT

Projekti është udhëhequr nga ana e grupit punues të përbërë nga ana e zyrtarëve të Komunës së Suharekës dhe pritet krijimi i një Njësie për Menaxhimin e Kontratës.